

21-22

F2

E drejta civile

TEZA 27

I. Shënoni me V shprehjet e vërteta dhe me X ato që janë të gabuara

- _____ 1. Shteti dhe personat juridikë shtetërorë nuk përgjigjen për detyrimet e njëri-tjetrit, përveç kur kjo është pranuar prej tyre ose është parashikuar shprehimisht në ligj.
- _____ 2. Për një person që nuk ka qenë në marrëdhënie pune ose nuk ka qenë i siguruar, masa e shpërbimit të dëmit të rrjedhur nga vdekja, caktohet nga gjykata në bazë të gjendjes ekonomike familjare që ai ka pasur para vdekjes.
- _____ 3. Kontrata detyron palët vetëm përsa është parashikuar në atë, pavarësisht se cfarë pasojash rrjedhin nga zbatimi i ligjit.
- _____ 4. Kreditorët nuk mund të janë solidarë; vetëm debitorët mund të janë solidarë.
- _____ 5. Vonesa e kreditorit i jep të drejtë debitorit të kérkojë shpërbimin e dëmit që ka ardhur si pasojë e kësaj vonese.
- _____ 6. Sendet e fituara me dhurim nga një anëtar i familjes bujqësore nuk janë pjesë e pasurisë së familjes bujqësore.
- _____ 7. Hipoteka mbi një send të ardhshëm është e pavlefshme.
- _____ 8. Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë të paslindur, as prindër ose të paralindur të tjerë, as vëllezër ose motra, apo të paslindur të këtyre, pasuria e trashëgimlënësit u kalon të afërmve më të afërt të tij, pa bërë dallim ndërmjet vijës atërore dhe asaj amësore, por gjithsesi jo më tej se shkalla e pestë.
- _____ 9. Prokura për të përfaqësuar palën në gjykatë mund të bëhet më shkresë të thjeshtë kur ajo lejohet nga dispozita ligjore.
- _____ 10. Lajthimi në llogarijtë mund të sjellë shpalljen e veprimit juridik si të pavlefshëm.
(10 pikë)

II. Plotësoni fjalitë dhe jepni sqarimet e mëposhtme:

a. Padia e kthimit është _____

b. Natyra ekonomike e detyrimit nënkuption _____

c. Kur trashëgimlënësi nuk ka lënë trashëgimtarë deri në shkallën e gjashtë, atëherë _____

d. Kamata ligjore është _____



E drejta civile

(10 pikë=3 + 2 + 2 + 3)

III. Shpjegoni ndryshimin koncepteve apo instituteve të mëposhtme:

- a. Cilat janë dallimet midis shitjes dhe furnizimit?

. (10 pikë)

IV. Emërtoni definicionet e mëposhtme duke dhënë konceptin përkatës.

- a. Kontrata me anë të së cilës njëra palë i kalon në pronësi pa shpërblim palës tjetër një send të caktuar ose një të drejtë reale të cilat ajo i pranon quhet _____.
- b. Personi juridik pa anëtarësi që ka për objekt arrijen e një qëllimi të ligjshëm me anë të destinimit të pasurisë në të mirë dhe interes të publikut quhet _____.
- c. Për mbledhjen e kredive përkatëse që lindin nga kontrata e transportit dhe për ushtrimin e privilegjit mbi sendet e transportuara përgjegjësia bie mbi _____.

d. Trashëgimtarët që bashkëjetonin me trashëgimlënësin në kohën e vdekjes së tij, kur thirren në trashëgim, marrin tej pjesës që u takon në pasurinë trashëgimore sendet shtëpiake të përdorimit të zakonshëm, përveç kur trashëgimlënësi ka disponuar ndryshe në testament. Ky është definitoni i _____.

(10 pikë=2 + 2 + 3 + 3)

V. Jepni shpjegimet e mëposhtme:



E drejta civile


a. Për cilën kontratë "risku" është një element thelbësor? Cilat janë format e riskut?

b. Listoni llojet e përgjegjësisë së transportuesit në kontratën e transportit të personave.

c. Cilat janë rastet e shuarjes së detyrimit për shkak të pamundësisë së ekzekutimit?

d. Cilët trashëgojnë në radhë të parë?

(10 pikë=4 + 2 +2+2)



TEZA 15
PROCEDURË PENALE

I. Shënoni me V ose G, përkatësisht përgjigjen e vërtetë ose të gabuar (çdo përgjigje e saktë - 1 pikë; gjithsej – 5 pikë):

1. Ndaj vendimit të prokurorit për mosfillimin e procedimit nuk mund të ushtrohet ankim.
2. I mituri në moshë 14-18 vjeç përjashtohet nga procedura e betimit para gjykatës.
3. Shkelja e rregullave për publicitetin e seancës gjyqësore sanksionohet me pavlefshmëri.
4. Eksperti ka të drejtë të kërkojë studimin e akteve që ndodhen në fashikullin e prokurorit.
5. Kur personi vepron në kushtet e mbrojtjes së nevojshme gjykata vendos pushimin e çështjes .

II. Vendasni shenjën “+” ose “x” tek alternativa e saktë (çdo përgjigje e saktë - 2 pikë; gjithsej – 10 pikë):

1. Cili nga pohimet e mëposhtme për figurën e mbrojtësit në procesin penal **nuk** është i saktë?

- kontakti i të pandehurit me mbrojtësin lejohet që nga çasti i arrestimit ose i ndalimit
- nuk lejohet përgjimi i bisedimeve midis të pandehurit dhe mbrojtësit të tij
- masat disiplinore ndaj mbrojtësit jepen nga Ministri i Drejtësisë
- mbrojtësi ka detyrimin e mbrojtjes teknike dhe të përfaqësimit të të pandehurit
- mbrojtësi nuk është nëpunës shtetëror dhe as i ngarkuar me një shërbim publik

2. Personi i pezulluar, qoftë edhe përkohësisht, nga detyrat publike apo nga ushtrimi i një profesioni, **nuk** mund të ushtrojë detyrën e ekspertit:

- varet nga lloji i ekspertimit
- asnjëherë, sepse pengohet nga ligji
- papajtueshmëri me detyrën e ekspertit ka vetëm i mituri
- ligji nuk vendos kufizime të tillë
- po, por vetëm në rastin kur ka edhe kufizime të tjera

3. Dokumentet që përbëjnë provë materiale:

- duhet të merren edhe nga personi që i mban, por vetëm kur ekziston një rrezik real që të dëmtohen ose të humbasin
- nuk mund të merren në qoftë se personi që i ka krijuar ose që i mban është i besueshëm
- duhet të merren cilidoqoftë personi që i ka formuar, por për t'i marrë nga personi që i mban mund të vendosë prokurori
- duhet të merren cilidoqoftë personi që i ka krijuar ose që i mban
- mund të merren cilidoqoftë personi që i ka krijuar ose që i mban

4. Në temën e provave është i vërtetë pohimi:

- gjatë hetimeve paraprake, provat merren nga mbrojtja dhe nga organi që procedon*
- faktet mund të provohen me çdo provë që plotëson kriteret e caktuara nga ligji*
- faktet mund të provohen vetëm nga provat e marra nga burimet e parashikuara në ligji*
- organi që procedon duhet të marrë vetëm provat që fajësojnë të pandehurin*
- vlera e provës paracaktohet nga ligji procedural penal*

5. Në përbajtje të fashikullit nuk mund të përfshihet:

- kerkesa për pranimin e padisë civile*
- aktet e caktimit të masave të sigurimit*
- procesverbali i këqyrjes së sendeve*
- relacioni shpjegues i oficerit të policisë gjyqësore*
- procesverbalet e transkriptimit të bisedave të përgjuara*

III. Pyetje konceptuale (2 pyetje, 10 pikë)

1. Çfarë kushtesh duhet të plotësohen që pavlefshmëria e një akti t'i transmetohet një akti tjetër (instituti i pavlefshmërisë së prejardhur) (4 pikë)

a)

b)

2. Gjyqtari hetimeve paraprake është i papajtueshëm me gjyqtarin e seancës paraprake? Si e kuptioni këtë rregull dhe cila është arsyja e vendosjes së tij (6 pikë)

IV. Pyetje krahasuese (15 pikë)

1. Bëni dallimin mes “*marrëveshjes për pranimin e fajësisë dhe caktimin e dënimit*” dhe “*gjykimit të shkurtuar*”.

V. Pyetje zhvilluese (10 pikë):

1. Sqaroni kuptimin dhe procedurën e simulimit të blerjes së lëndës narkotike dhe garancitë e mbrojtjes së personit?


TEZA 12
E DREJTË PENALE

1. E vërtetë/ e gabuar. (5 pikë)


1. _____ Të gjithë pesonat juridikë përgjigjen penalish për vepra penale të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre.
2. _____ Vetëm përsitim i parregullt material është kusht thelbësor i qenies së veprës penale të korruptionit.
3. _____ Rrethanat lehtësuese janë cituar në Kodin Penal në mënyrë ezauruese.
4. _____ Nëse nuk ka një plan të paramenduar për shkatërrimin plotësisht apo pjesërisht të një grupi nacional etj, atëherë nuk ekziston vepra penale e genocidit.
5. _____ Organizimi i lojrave të fatit nuk kërkon paraprakisht të sigurohet leje administrative për ushtrimin e tyre.

2. Ekstradimi lejohet kur: (10 pikë)


(Handwritten signature over 10 lines)



3. Çfarë konsiderojmë «Lajthitje» në të drejtën penale? (13 pikë)



4. Kolegjet e Bashkuara të Gjykatës së Lartë lidhur me kriterin detyrues për vlerën si
pasojë e rëndë, në rastet e vjedhjes së parashikuar nga neni 134 i KP. (12 pikë)



5. Shtrohet pyetja: «Cilat janë ‘arsyet e veçanta’ sipas nenit 64 ‘Lirim me kusht’? Koha e provës dhe kriteret, rastet e revokimit të vendimit» (10 pikë)



ANSWER

Diagram illustrating the concept of 'causes of exception' (arsyet e veçanta) under Article 64 regarding the revocation of a decree. The diagram shows a large rectangular area divided into four quadrants by vertical and horizontal lines. The top-left quadrant contains a zigzag pattern, the top-right a curved line, the bottom-left a straight line, and the bottom-right a small cluster of dots. This visual representation likely corresponds to the different types of causes mentioned in the question.

1000 PESO DRAFT



PROCEDURË CIVILE

TEZA 21

1. Përcaktoni nëse pohimi i mëposhtëm është i vërtetë (V) apo i gabuar (X)

- a. Kompetenca tokësore e gjykatës mund të ndryshohet me marrëveshje të palëve për paditë për pjestimin e trashëgimit. ()
- b. Paditë që kanë për objekt kundërshtimin e veprimeve të kryera nga përmbaruesit për ekzekutimin e detyruar ngrihen në gjykatën ku ka banimin kreditori. ()
- c. Përprojekjet për pajtim mund të përsëriten në çdo fazë të hetimit gjyqësor. ()
- d. Paditësi, gjatë hetimit gjyqësor ka të drejtë të kërkojë kamatat edhe kur ka ndryshuar shkakun ligjor të padisë. ()

8 pikë

2. Rrumbullakosni përgjigjen e saktë:

Kërkesa për sigurimin e provës:

- a) Në rast se padia nuk është ngritur, paraqitet në gjykatën e vendit ku ndodhet personi që do të pyjet;
- b) Edhe në rast se padia nuk është ngritur, paraqitet në gjykatën që do të paraqitet padia;
- c) Në rast se padia nuk është ngritur, paraqitet në gjykatën ku ka banimin paditësi.

4 pikë

3. Shpjegoni çfarë vendos gjykata, nëse paditësi nuk paraqitet në seancën përgatitore gjatë procesit civil në shkallë të parë, pa ndonjë shkak të arsyeshëm.

6 pikë

4. Të përbashkëtat dhe dallimet ndërmjet kërkesës dhe kërkesëpadisë, si akte procedurale që iniciojnë procesin gjyqësor.

10 pikë

PROCEDURË CIVILE

5. Cili është afati i paraqitjes së kërkesës për rishikimin e një vendimi gjyqësor civil të formës së prerë?

4 pikë

6. Gjykata vendos pezullimin e gjykimit kur:

- a) _____
b) _____
c) _____
d) _____
e) _____

10 pikë

7. Analizoni shprehjen: “Përjashtohen nga sekuestrimi i pasurisë së debtorit sendet e nevojshme për sigurimin e jetesës”.

8 pikë



Teza 5
E DREJTA KUSHTETUESE


I. Shënoni përkatësish me S ose G, sipas rastit, përgjigjen e saktë ose të gabuar(10 pikë)

1.	Për çështjet që lidhen me kufizimin e të drejtave të njjerit Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut ka të njëtin status si Kushtetuta e Shqipërisë	S
2.	Kuvendi mund të votojë një mocion mosbesimi ndaj Kryeministrit pa qenë e nevojshme të zgjedhë një Kryeministër të ri	G
3.	Ligji i miratuar nga Kuvendi, i cili as nuk shpallet dhe as nuk kthehet përrishqyrtim nga Presidenti i Republikës brenda 20 ditëve, konsiderohet i pezulluar	G
4.	Këshilli i Ministrave nxjerr rezoluta	G
5.	Organi ekzekutiv i Bashkisë është këshilli	G
6.	Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur është dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një kundervajtje penale.	G
7.	Inspektori i Lartë i Drejtësisë zgjidhet për një periudhë 9-vjeçare, pa të drejtë rizgjedhje	S
8.	Gjykata Kushtetuese, per kontrollin abstrakt te kushtetutshmerise se akteve normative, vihet në lëvizje jo vetëm me kërkesë të Presidentit të Republikës	S
9.	Prefekti mund të shkarkohet nga Kuvendi	G
10.	Drejtuesi i Prokurorisë së Posacme zgjidhet për 3 vjet, pa të drejtë rizgjedhje	S

II. Jepni karakteristikat e përbashkta dhe dallimet ndërmjet koncepteve/instituteve të mëposhtme (10 pikë):

Shtetit ligjor dhe shtetit të së drejtës





III. Rrethoni alternativën e saktë (10 pikë)

1. Parimi i proporcionalitetit ka të bëjë me:

- a. zbatimin e përpiktë të legjislacionit në fuqi
- b. përdorimin e mjeteve të përshtatshme dhe në balancë me qëllimet që synohen të arrihen;
- c. trajtimin e barabartë të të gjitha subjekteve para ligjit
- d. marrjen e masave që mundësojnë pjesëmarrjen sa më të gjerë të personave privatë në procesin administrativ



2. Është i detyruar t'i përgjigjet interpellancave:

- a. Presidenti i Republikës
- b. Kryetari i Kuvendit
- c. Kryeministri
- d. Avokati i Popullit

3. Akti normativ i nxjerrë në rast nevoje dhe urgjencë nga Këshilli i Ministrave dhe që ka fuqinë e ligjit humbet fuqinë, në qoftë se nuk miratohet nga Kuvendi brenda:

- a. Pesëmbedhjetë ditëve
- b. tridhjetë ditëve
- c. dyzet e pesë ditëve
- d. gjashtëdhjetë ditëve

4. Kuvendi zgjedh gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese me:

- a. jo më pak se tri të pestat e të gjithë anëtarëve të tij
- b. jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të tij
- c. me të paktën shumicën e të gjithë anëtarëve të tij
- d. me të paktën shumicën e votave në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij

5. Kur ndaj Gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese caktohet masa e sigurimit personal “arrest në burg” për kryerjen e një vepre penale, ai pezullohet nga detyra me vendim të:

- a. Gjykatës së posaçme për gjykimin e veprave penale të korruptionit dhe krimit të organizuar.
- b. Prokurorisë së Posaçme
- c. Kuvendit
- d. Gjykatës Kushtetuese

IV. Çfarë procedure ndiqet për shkarkimin e Prokurorit të Përgjithshëm dhe shkarkimin e Prokurorit të Prokurorisë së Posaçme



V. Cili është qëndrimi i Gjykatës Kushtetuese (argumentet kryesore) lidhur me interpretimin e neneve 96 dhe 97 të Kushtetutës⁵, nëse Kryeministri i emëruar nga Presidenti i Republikës miratohet në Kuvend njëherësh me programin politik dhe përbërjen e Këshillit të Ministrave ? (10 pikë)

⁵ Kryeministri i emëruar . . . i paraqet për miratim Kuvendit, brenda 10 ditëve, programin politik të Këshillit të Ministrave së bashku me përbërjen e tij.





KAZUS 7⁷

Rrethanat e faktit

I demtuarit B.LI kishte punuar ne Itali me vellane e te gjykuarit T.P, A.P, i cili i kishte dhene 10 milion lireta qe t'ia dergonte familjes se tij. Njekohesht, A.P kishte njoftuar familjaret nepermjet telefonit per dergimin e parave dhe i kishte svaruar qe nje pjese te shumes t'ja jepin te gjykuarit E.B, per shlyerjen e nje borxhi.

Duke pare se i demtuarit nuk po i sillte te hollat, pasi me to kishte blere nje makine, i gjykuari T.P se bashku me dy te gjykuarit e tjere E.B, dhe P.P, me date 25.09.2001, kane shkuar ne nje lokal ne fshatin Fierze, ku i demtuarit drekonte me dy shoke te tij, me force dhe nen kercenimin e armes e kane marre me vehte. Ne vijim te veprimeve te tyre, kane hipur ne dy makina, ne ate tip "BMW" te vete te demtuarit dhe nje tjeter tip "Golf" dhe jane nisur ne drejtum te fshatin Pllane, Lezhe. Duke qene se policia, e lajmeruar nga shoket te demtuarit, eshte vene ne ndjekje te tyre, ne fshatin Pllane ata kane lene makinat dhe jane ngjitur nje pjese rruge me kembe ne drejtum te malit. Me pas, duke qene te ndjekur nga policia, e kane lene te lire dhe pasi kane hedhur armen jane larguar duke ju fshehur ndjekjes. Per sa me siper, te gjykuarit jane akuzuar nga organi i prokurorise per veprin penale te rrumbimit te personit te kryer ne bashkepunim, si dhe armembajtjes pa leje.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mirditë, ka vendosur:

Pushimin e gjykimit te çështjes penale per te pandehurin E.B per veprin penale te vetëgjyqësisë, te kryer ne bashkëpunim, sipas nenit 277 e 25 te Kodit Penal, pasi eshtë amnistuar.

Pushimin e gjykimit te çështjes penale per te pandehurin T.P per veprën penale te vetëgjyqësisë, te kryer ne bashkëpunim, sipas nenit 277 e 25 te Kodit Penal, pasi eshtë amnistuar.

Pushimin e gjykimit te çështjes penale per te pandehurin P.P per veprin penale te vetëgjyqësisë, te kryer ne bashkëpunim, sipas nenit 277 e 25 te Kodit Penal, pasi eshtë amnistuar.

Deklarimin fajtor te te pandehurit P.P per veprën penale te mbajtjes pa leje te armëve luftare dhe ne bazë te nenit 278, paragrafi i dyte i Kodit Penal dënimin e tij me 5 muaj burgim, dënim i cili eshtë vuajtur.

Deklarimin e pafajshëm te te pandehurve E.B e T.P per veprën penale te mbajtjes pa leje te armëve luftare, te parashikuar nga neni 278, paragrafi i dyte i Kodit Penal.

Gjykata e Apelit Tiranë, ka vendosur:

Lënien ne fuqi te vendimit te Gjykatës se Rrethit Gjyqësor Mirdite.

⁷ Vendimi Unifikues Penal i GJL Nr. 1, datë 27.03.2008.



Kundër këtyre vendimeve ka paraqitur rekurs prokurori, i cili ka kërkuar ndryshimin e tyre dhe deklarimin fajtor të tre të pandehurve për veprën e heqjes së paligjshme të lirisë në bashkëpunim, parashikuar nga neni 110, paragrafi i dytë i Kodit Penal dhe denimin e secilit me 3 vjet burgim, duke parashtuar këto shkaqe:

- Të dy gjykatat nuk kanë marrë në analizë elementet e veprës penale të heqjes së paligjshme të lirisë dhe ndryshimet që kjo vepër ka me atë të vetëgjyqësisë, si dhe konkurrimin e veprave në rastin konkret.
- Të pandehurit në bashkëpunim me njëri-tjerin i kanë hequr në mënyrë të paligjshme lirinë të demtuarit B.LI, duke e marrë, futur me dhunë në makinë, më pas e kanë nxjerrë nga makina dhe kane ecur rrugës së malit së bashku dhe e kanë lëshuar vetëm nga frika e policisë. Po të mos ishte ndërhyrja e policisë të pandehurit nuk kishin për ta lëshuar të dëmtuarin.
- Vetëgjyqësia, parashikuar nga neni 277 i Kodit Penal, si vepër drejtobet kundër pasurisë apo interesave të tjera që i pandehuri mendon se i takon, pa i zgjidhur në rrugë ligjore, por jo kundër personit. Po qe se gjatë kryerjes së veprës së vetëgjyqësisë ushtrohet dhunë në forma të ndryshme ndaj personit, ku mund të shkaktohen dëmtime trupore, apo hiqet liria. Këto veprime konkurrojnë me vetëgjyqësinë, prandaj të pandehurit duhet të përgjigjen për veprën penale të vetëgjyqësisë dhe heqjes së paligjshme të lirisë, të kryer në bashkëpunim, të parashikuara nga nenet 277 e 25, si dhe 110, paragrafi i dytë i Kodit Penal.

Në gjykimin e çështjes në Kolegin Penal të Gjykatës së Lartë, prokurori ndryshoi përsëri qendrim lidhur me kualifikimin e veprës penale nga heqje e paligjshme e lirisë dhe vetëgjyqësi, në rrëmbim personi të kryer në bashkëpunim, nen 109 e 25 te Kodit Penal. Ai arsyeton se veprimet e të gjykuarive i përgjigjen plotësish elementeve të anës objektive të veprës penale të rrëmbimit të personit, që behet jo vetem per te fituar pasuri, por edhe per te realizuar kushte a kerkesa te tjera e çdo qellim tjeter.

Kolegi Penal i Gjykatës së Lartë, diskutoi çështjen në fjalë dhe vëren se ka mendime të kundërtë lidhur me interpretimin dhe cilësimin ligjor të veprës së kryer nga të gjykuarit, nëse është "rrëmbim personi", "heqje e paligjshme e lirisë", "vetëgjyqësi", apo konkurrim i tyre me njëra-tjetrën. Për këtë arsy e ka dërguar çështjen në Kolegjet e Bashkuara për përcaktimin e saktë të praktikës gjyqësore lidhur me cilësimin juridik të veprës penale dhe të interpretimit gjyqësor të dispozitive të nenit 109, 110 dhe 277 të Kodit Penal.

A) Jepni përgjigjen e pyetjeve të shtuara për diskutim:

1. *Vepra penale e kryer nga te gjykuarit është ajo e rrëmbimit ose e mbajtjes peng të personit, parashikuar në nenin 109 të Kodit Penal, apo ajo e heqjes së paligjshme të lirisë dhe vetëgjyqësia, parashikuar nga nenet 110 dhe 277 në lidhje me nenin 25 të K.P. (10 pike)*
2. *Cfarë vepra penale të tjera ka konsumuar i gjykuari P.P ? (10 pike)*
3. *Për të bërë dallimin ndërmjet veprave penale të lartpermendura, si dhe për të konsttuuar faktin e konkurrit ose jo ndërmjet tyre, a është e mjaftueshme vetëm analiza e anës subjektive për të bërë kualifikimin e saktë të veprës penale të kryer nga të gjykuarit, apo elementet dhe rrëthanat e anës subjektive, duhen shqyrtuar dhe analizuuar së bashku me elemente e rrëthana të tjera të anës objektive ? (10 pike)*
4. *Cilat janë elementet e figurës së të tre veprave penale, ajo e rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit (neni 109), heqjes së paligjshme të lirisë (neni 110) dhe vetëgjyqësisë (neni 277) ? (10 pike)*
5. *A konkurojne ato me njera tjetren (10 pike)*





KAZUS 5⁶

Rrethanat e faktit

Paditësit E. H, kanë kërkuar me padi:

- Konstatimi i zgjidhjes së marrëdhënies së punës me shkak abuziv, detyrimi i punëdhënës të dëmshpérblejë paditësen me pagën e një viti pune për shkak të zgjidhjes së kontratës për shkak abuziv;
- konstatim i zgjidhjes për shkak të paarsyeshëm dhe detyrimi për të dëmshpérbyer me pagën e një viti pune;
- pagimi i dy muajve pagë për mosrespektim të procedurës dhe pagimi i pushimeve të papaguar.

Paditësja E.H ka qënë në marrëdhënie pune pranë anës së paditur në pozicionin e Këshilltarit të Licensimit të Biznesit, me kontratë me afat të përcaktuar, nga data 16.02.2009 deri më datë 22.01.2010.

Ana e paditur e këtij gjykimi, Chemonics International INC është zyrë e përfaqësimit të Kompanisë Chemonics International INC, shoqëri e themeluar sipas Ligjit të Përgjithshëm të Shoqërive të shtetit Delaware. Zyra e përfaqësimit në Shqipëri është regjistruar me vendimin nr.36546, datë 13.11.2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në ushtrim të aktivitetit për zbatimin e projektit të reformës së Administratës Publike në Shqipëri ka kontraktuar me USAID, organizatë publike e krijuar nga qeveria e SHBA-së dhe financohet prej saj.

Me shkresën e datës 17.06.2009 ana e paditur ka njoftuar paditësen për zgjidhjen e menjëhershme të kontratës së punës dhe i ka kërkuar të paraqitet në datë 24.06.2009 për bisedime rreth arsyeve të zgjidhjes së kësaj kontrate. Më datë 24.06.2009 paditëses i është njoftuar vendimi përfundimtar për zgjidhjen e marrëdhënies së punës.

Paditësja, me pretendimin se zgjidhja e kontratës së punës është me shkak abuziv, pa shkaqe të arsyeshme, ka kërkuar zgjidhjen e pasojave ekonomike të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr.4088 Akti, datë 12.04.2010, ka rrëzuar kërkesën e palës së paditur për nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksonit.

⁶ Vendimi Unifikues i GJL Nr. 8, datë 27.03.2011.



Kundër vendimit ka ushtruar ankim të veçantë ana e paditur Chemonics International INC, me të cilin kërkon prishjen e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe nxjerrjen e çështjes jashtë juridiksionit të gjykatave shqiptare.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në seancën gjyqësore të datës 27.05.2010, duke marrë shkas nga çështja në shqyrtim dhe duke pasur parasysh se në praktikë kanë lindur keqkuptime lidhur me zbatimin e nenit 39 të Kodit të Procedurës Civile; me zbatimin e marrëveshjeve dy pafshët e njëshkruara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me qeveritë e vendeve të tjera, si dhe nga Konventa e Vjenës "Mbi Marrëdhëniet Diplomatike" (1961). Konventa për "Privilegjet dhe Imunitetet e Agjensive të Specializuara" dhe anekset e saj, miratuar me ligjin nr.9105, datë 17.07.2003, ka arritur në konkluzionin se është rasti të njehsohet praktika gjyqësore lidhur me zbatimin e kësaj dispozite dhe marrëveshjeve dypalëshe.

Jepni përgjigjen e pyetjeve të shtruara për diskutim:

- (a) *Kur midis subjekteve që gëzojnë imunitet nga juridiksioni gjyqësor shqiptar (sipas Konventës për Privilegjet dhe Imunitetet e Agjensive të Specializuara dhe anekset e saj, miratuar me ligjin nr.9105, datë 17.07.2003 dhe Marrëveshjeve Dypalëshe të lidhura midis Qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Qeverive të vendeve të tjera) janë lidhur kontrata punësimi me punëmarrës shqiptarë, a kanë gjykatat shqiptare juridiksion për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve që lindin nga këto marrëdhënie pune? (5 pikë)*
- (b) *Nëse në kontratat e punësimit të lidhura midis subjekteve të mësipërm me cilësinë e punëdhënësve dhe punëmarrësve shqiptarë është përcaktuar se për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lindura për shkak të marrëdhënies së punës palët mund t'i drejtohen gjykatës shqiptare, a do të konsiderohet një gjë e tillë si pranim vullnetar i juridiksionit shqiptar në kuptim të nenit 39/a të Kodit të Procedurës Civile? (10 pikë)*
- (c) *Analizoni kuptimin e nenit 39 te Kodit te Procedures Civile dhe sqaroni nese jemi para rastit te pikes a) te tij qe parashikon shprehjen e vullnetit per pranimin vullnetar te juridiksionit te gjykatave shqiptare? (5 pikë)*
- (c) *Si ka vendosur Gjykata e Lart ne kete rast lidhur me fatin e gjykimit dhe vendimmarjen e gjykats se shkalles se pare dhe te apelit? (15 pikë)*
- (d) *Çfar ka unifikuar Gjykata e Larte ne kete rast? (15 pikë)*

